



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

MINISTRI

Nr. 1303/prot.
2

Tiranë, më 19.03/2020

URDHËR

Nr. 190, datë 19.03.2020

**PËR MBYLLJEN E VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONEVE ARSIMORE PUBLIKE
DHE JOPUBLIKE DHE ÇERDHEVE PËR KUFIZIMIN E PËRHAPJES SË
INFEKSIONIT COVID-2019**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 4, gërma "a", të Ligjit Nr.15/2016, "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", si edhe udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-2019,

U R D H Ë R O J:

1. Mbylljen e institucioneve arsimore publike dhe jopublike dhe çerdheve deri në datën 03.04.2020.
2. Urdhri i Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Nr 153/1, datë 09.03.2020 "Për mbylljen e veprimtarisë së çerdheve për kufizimin e përhapjes së infeksionit COVID-19" dhe Urdhri Nr.135 datë 9.03.2020 "Për mbylljen e institucioneve arsimore për kufizimin e përhapjes së infeksionit COVID-19", shfuqizohen.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, ministria përgjegjëse për arsimin dhe institucionet e qeverisjes vendore.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Ogerta Manastirliu

